



Nr./Br. 1023 - 2017

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenin 3.3 të Rregullës Zgjedhore Nr.06/2013, për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 09.06.2017, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Rritjen e Numrit të Vëzhguesve në QNR

I. Miratohet rekomandimi i QNR-së, për rritjen e numrit të vëzhguesve në QNR, për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me 11 qershor 2017, si në vijim:

-Dymbëdhjetë (12) deri në njëzetë (20) vëzhgues, nga i njëjti subjekt apo organizatë e akredituar, do të vëzhgojnë procesin e punës në QNR, varësisht nga operacionet që do të zhvillohen.

II. Obligohet Sekretariati për implementimin e këtij vendimi.

III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 09.06.2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka

